

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2001/8

**PËR ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 1999/16, TË NDRYSHUAR, MBI
THEMELIMIN E AUTORITETIT QENDROR FISKAL DHE ÇËSHTJE TË TJERA LIDHUR
ME TË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë me nenin 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/16 të datës 6 nëntor 1999, të ndryshuar, mbi Themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal dhe Çështje të Tjera Lidhur me Të,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/3 të UNMIK-ut të datës 31 gusht 1999, të ndryshuar, mbi Themelimin e Doganave dhe Shërbimeve të Ngjashme në Kosovë, Rregulloren nr. 2000/2 të UNMIK-ut të datës 22 janar 2000, të ndryshuar, mbi Akcizat në Kosovë, Rregulloren nr. 2000/3 të UNMIK-ut të datës 22 janar 2000 mbi Tatimin në Shitje në Kosovë si dhe Rregulloren nr. 2000/11 të UNMIK-ut të datës 31 maj 2000 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar në Kosovë,

Me qëllim të kontrollimit të transportimit të trafikut komercial dhe të mallrave komerciale që hyjnë në Kosovë dhe dalin nga Kosova dhe të vlerësimit, vënies dhe mbledhjes së taksave dhe, aty ku kërkohet, të taksave doganore mbi mallrat e tilla komerciale,

Shpall urdhëresën e mëposhtme administrative:

Sipas kësaj urdhërese administrative:

(a) ‘Kufi administrativ’ do të thotë vija ndarëse ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dhe ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, ashtu siç është përkufizuar në Rregulloren nr. 2001/10 të UNMIK-ut të datës 24 maj 2001 mbi Ndalimin e Kalimeve të Paautorizuara të Kufirit Shtetëror/Administrativ;

(b) ‘Mjete të transportit komercial’ do të thotë çdo automjet rrugor, duke përfshirë kamionët, maunat me një rimorkio, maunat me dy rimorkio si dhe çdo kombinim të automjeteve, kamionëve të zbrazët, kamionëve që bartin ngarkesa humanitare dhe kamionëve të kontraktuesve të KFOR-it që përdoren në trafikun komercial ose në transportimin industrial të mallrave, me pagesë a pa pagesë, duke përjashtuar automjetet ushtarake të KFOR-it;

(c) ‘Mallra komerciale’ do të thotë mallrat të cilat për nga natyra ose sasia barten për qëllime komerciale ose industriale dhe

(ç) ‘Trafik komercial’ do të thotë transportimi komercial i mallrave.

Neni 2

Caktimi i vendkalimeve të autorizuara kufitare dhe i rrugëve të aprovuara për mallra komerciale

- 2.1 Për t'u bërë kontrolli dhe për t'u arritur siguria e mjaftueshme, si dhe duke marrë parasysh kërkesat e tregtisë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në konsultim me drejtorin e përgjithshëm të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut, me Komisararin e Policisë së UNMIK-ut dhe me Komandantin e KFOR-it (KOMKFOR) cakton dhe anulon vendkalimet e autorizuara kufitare dhe rrugët e aprovuara të mallrave komerciale.
- 2.2 Caktimi dhe anulimi konform nenit 2.1 do të shpallen publikisht.

Neni 3

Vendkalimet e autorizuara kufitare dhe rrugët e aprovuara të mallrave komerciale

- 3.1 Vendkalimet e autorizuara kufitare për bartjen e mallrave me anë të mjeteve komerciale të transportit për në Kosovë dhe nga Kosova për në vende të tjera janë parashtruar në Shtojcën A.
- 3.2 Asnjë person fizik a juridik nuk mund të bartë mallra komerciale me mjete komerciale të transportit për në Kosovë dhe nga Kosova për diku tjetër përmes ndonjë pikëkalimi të paautorizuar kufitar, përveç nëse kjo përjashtimisht autorizohet nga ana e autoriteteve tatimore.

Neni 4

Rrugët e aprovuara hyrjedalëse të vendkalimeve të autorizuara kufitare

- 4.1 Rrugët e aprovuara ndërmjet vendkalimeve të autorizuara kufitare dhe zyreve tatimbledhëse - Depove të brendshme të zhdoganimit për bartjen e mallrave komerciale me anë të mjeteve të transportit komercial për në Kosovë dhe nga Kosova për diku tjetër janë parashtruar në Shtojcën B/1 dhe B/2.
- 4.2 Asnjë person fizik a juridik nuk mund të bartë mallra komerciale me anë të mjeteve komerciale të transportit për në Kosovë dhe nga Kosova për diku tjetër përmes ndonjë rruge të aprovuar, me përjashtim nëse kjo autorizohet nga ana e autoriteteve tatimore.

Neni 5

Procedura

- 5.1 Personi fizik a juridik që bart mallra komerciale me anë të mjeteve komerciale të transportit për në Kosovë dhe nga Kosova për ndonjë vend tjetër duhet që:
- (a) të ndalet në vendkontroll në vendkalimin e autorizuar kufitar dhe t'i mundësojë nëpunësit kompetent në vendkontroll që t'i inspektojë dhe t'i evidencojë mallrat komerciale;
 - (b) të mos i largojë mallrat komerciale nga vendkontrolli në vendkalimin e autorizuar kufitar pa lejen e nëpunësit kompetent në vendkontroll dhe
 - (c) t'ia ofrojë nëpunësit kompetent në vendkontroll në vendkalimin e autorizuar kufitar tërë dokumentacionin përkatës tatimor, e aty ku kërkohet edhe atë doganor. Nëpunësi kompetent ka të drejtë që të marrë origjinalin e dokumenteve përkatëse tatimore dhe aty ku kërkohet edhe ato doganore ose

kopjet e tyre për zhdoganim të mallrave komerciale nëse dhe kur është e nevojshme në përputhje me ligjin në fuqi si dhe e drejton personin e tillë për zhdoganim të mallrave komerciale tek Zyrja tatimbledhëse/Depoja e brendshme e zhdoganimit.

5.2 Asnjë person fizik a juridik që bart mallra komerciale me anë të mjeteve komerciale të transportit për në Kosovë dhe nga Kosova për ndonjë vend tjetër nuk mund t'i largojë ose të tentojë t'i largojë mallrat komerciale kur gjendet në cilëndo pjesë të rrugës së aprovuar ndërmjet pikëkalimit të autorizuar kufitar dhe Zyrës së caktuar tatimbledhëse - Deposë së brendshme të zhdoganimit.

5.3 Policia e UNMIK-ut mjetet e transportit komerciale që ndalen në rrugët e paaprovuara, në rastet kur ka dëshmi të arsyeshme për të dyshuar se taksat përkatëse dhe, aty ku kërkohet, detyrimet doganore nuk janë dëshmuar, i përcjell për veprim të mëtejshëm deri te Zyra tatimbledhëse -Depoja e brendshme e zhdoganimit.

5.4 Çdo shkelje e dispozitave konform kësaj urdhërese administrative dhe çdo pengim i nëpunësit kompetent në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje nga ndonjë person fizik a juridik përbën kundërvajtje dhe i nënshtrohet dënimit konform ligjit në fuqi, duk përfshirë edhe ato të parashtruara në Rregulloren nr. 2000/20 të UNMIK-ut të datës 12 prill 2000 mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore.

Neni 6 Ecuria administrative

6.1 Kjo urdhëresë administrative zbatohet nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e gjithmbarshme të UNMIK-ut përmes zyrtarëve tatimorë, zyrtarëve doganorë, policisë dhe forcave të sigurisë si dhe çdo autoriteti tjetër të caktuar nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

6.2 Orari i punës për bartjen e mallrave komerciale me anë të mjeteve të transportit komercial në vendkontroll në vendkalimin e autorizuar kufitar si dhe për Zyrën e caktuar tatimbledhëse -Deponë e brendshme të zhdoganimit, caktohet nga ana e zëvendësit të Përfaqësuesit Special për Rindërtim, Rimëkëmbje dhe Zhvillim ose nga ana e zyrtarit të caktuar nga ai/ajo përmes nxjerrjes së një udhëzimi administrativ i cili shpallet publikisht.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Kjo urdhëresë administrative hyn në fuqi më 6 qershor 2001.

Hans Haekkerup
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

SHTOJCA A

VENDKALIMET E AUTORIZUARA KUFITARE PËR MALLRAT KOMERCIALE ME ANË TË MJETEVE TË TRANSPORTIT KOMERCIAL

Shtojca A Referenca	Kordinatat e rrjetit	Anglisht	Shqip	Serbisht
		PRISTINA/PRISTINË	PRISHTINË	PRISTINA
1.	EN 200 538	Gate 3	Merdar	Merdare
		GNJILANE/GJILAN	GJILAN	GNJILANE
2.	EN 554 034	Gate 5 (CP 75)	Konçul	Konculj
		PEC/PEJË	PEJË	PEC
3.	DN 413 348	Kulina	Savine Vode	Savine Vode
		MITROVICA/MITROVICË	MITROVICË	MITROVICA
4.	DN 634 566	D31, Route Hen	Tabaler	Tabaler
5.	DN 753 844	Gate 1	Rudnicë	Rudnica

SHTOJCA B/1

RRUGËT E APROVUARA PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE KOMERCIALE ME ANË TË MJETEVE TË TRANSPORTIT KOMERCIAL QË HYJNË/DALIN NGA KOSOVA PËRMES VENDKALIMEVE TË AUTORIZUARA KUFITARE

Shtojca B/1 Referenca	Vendkalimet e autorizuara kufitare	Rrugët e aprovuara	Zyra tatimbledhëse/Depoja e brendshme e zhdoganimit (ZT/DBZ)
PRISHTINË			
1.	Porta 3	Rruga ‘Snake’	(ZT/DBZ) në Komunën e Podujevës
GJILAN			
2.	Porta 5	Rruga ‘Stag’	(ZT/DBZ) në Komunën e Kamencisë ose të Gjilanit
PEJË			
3.	Kulina	Rruga ‘Rozhajë– Pejë	(ZT/DBZ) në Pejë
MITROVICË			
4.	Porta D31, Rruga ‘Hen’	Rruga ‘Hen’	(ZT/DBZ) në Mitrovicë
5.	Porta 1	Rruga ‘Bull’	(ZT/DBZ) në Mitrovicë